



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0833

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "WOOD COMPANY" SH.P.K., kundër Njoftimit për kontratë (B05) lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME LËNDË DJEGSE - PELET DHE DRU PËR NEVOJAT E INSTITUCIONEVE KOMUNALE - PROJEKT KORNIZ RITENDERIM" me numër të prokurimit 611-23-10866-1-1-1, inicuar nga Komuna e Glllogocit në cilësinë e Autoriteti kontraktues (AK), më datën 23.11.2023, mori këtë:

Vendim

I.MIRATOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Wood Company" Sh.P.K. me nr. 2023/0833 e datës 25.10.2023 kundër Njoftimit për Kontratë të datës 10.10.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Glllogocit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lëndë djegëse - pelet dhe dru për nevojat e institucioneve komunale - projekt kornizë ritenderim" me numër të prokurimit 611-23-10866-1-1-1.

II.DETYROHET Autoriteti Kontraktues - Komuna e Glllogocit që të zgjatë afatin për dorëzimin e ofertave si dhe të ndryshoj/plotësoj dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I, duke marrë parasysh të gjeturat dhe konstatimet e potencuara më poshtë në këtë vendim si dhe të gjeturat dhe konstatimet e potencuara në vendimin e OSHP 2023/0644 të datës 03.10.2023.

III. DETYROHET Autoriteti Kontraktues - Komuna e Glllogocit për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

IV. LEJOHET kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimi të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Gllogocit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 10.10.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me lëndë djegëse - pelet dhe dru për nevojat e institucioneve komunale - projekt kornizë ritenderim” me numër të prokurimit 611-23-10866-1-1-1. Data e hapjes së ofertave është caktuar 26.10.2023.

Ky aktivitet i prokurimit është duke u zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,008,000.00€.

Me datë 18.10.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin për Kontratë të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 24.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 25.10.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0833.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - *“Përmes kërkesës nr. 3 te neni 7.1&7.2 në dosjen e tenderit është kërkuar një vërtetim nga autoriteti pyjor komunal i Komunës së Drenasit dhe nga komuna e selisë së regjistrimit të operatorit ekonomik që kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore. Këto kërkesa janë në kundërshtim me nenin 65 të LPP ku parashihet që dëshmitë mund të kërkojnë vetëm nga gjykatat kompetente. Prandaj kërkesa më sipër në DT është e mbuluar realisht me kërkesat e përshtatshmërisë së DT. Për më tepër Agjencia Pyjore e Kosovës me datë 22.07.2020 ka dërguar kërkesën me nr. 2948 drejtuar të gjitha komunave duke njoftuar se APK nuk do të pajisë asnjë OE me këto vërtetime”.*

Pretendimi i dytë (II) - *“Përmes kërkesës te neni 9.1&9.2 në dosjen e tenderit është kërkuar që të paraqiten kontratat e furnizimeve të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej 1,500,000.00€ nga të cilat 1,300,000.00 duhet të jenë referenca për dru dhe 200,000.00€ duhet të jenë referenca për pelet”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 27/A dhe 69 të LPP si dhe nenet 17, 18 dhe 25 të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.10.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 01.11.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“ankesa e OE ankues të miratohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet sipas ekspertizës 2023/644 dhe të zgjasë afatin sipas RRPP”.*

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: *“Këto pretendime ankimore janë parashtruar edhe në vendimin paraprak lidhur me këtë aktivitet të prokurimit sipas vendimit të OSHP e shenjë 2023/0644 të datës 03.10.2023. Autoriteti Kontraktues në atë kohë ishte pajtuar me ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe me rekomandimet e dhëna në ekspertizë. Eksperti shqyrtues pas kërkesave drejtuar*

Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe shkresës së pranuar nga operatori ekonomik ankues që dëshmon refuzimin e marrjes së një dokumenti të tillë nga Komuna e Prishtinës, ka rekomanduar që dëshmia nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe Vërtetimi nga Autoriteti Pyjor Komunal të largohen si kërkesa të dosjes së tenderit ndërsa në vend të tyre si kërkesë të jetë vetëm vërtetimi nga gjykata kompetente sipas nenit 65 të LPP. Autoriteti Kontraktues me rastin e ritenderimit sërish përmes kërkesës nr. 3 të neni 7.1&7.2 në dosjen e tenderit është kërkuar një vërtetim nga autoriteti pyjor komunal i Komunës së Drenasit dhe nga komuna e selisë së regjistrimit të operatorit ekonomik që kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore. Eksperti shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me rekomandimet e ekspertizës 2023/644 dhe vendimit të OSHP më të njëjtin numër pasi që ka vendosur kriterin e njëjtë diskriminues dhe në kundërshtim të plotë me rekomandimin që të për zbatimin e nenit 65 të LPP. Po ashtu me aplikimin e kërkesës si më lartë eksperti shqyrtues vlerëson se janë shkel parimet e nenit 7 të LPP. Prandaj Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i dhe kemi të bëjmë me shkelje të nenit 97 paragrafi h) të RRPP”.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: “Po ashtu edhe këto pretendime ankimore janë parashtruar edhe në vendimin paraprak lidhur me këtë aktivitet të prokurimit sipas vendimit të OSHP e shenjë 2023/0644 të datës 03.10.2023. Autoriteti Kontraktues në atë kohë ishte pajtuar me ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe me rekomandimet e dhëna në ekspertizë. Eksperti shqyrtues në ekspertizën me nr. 2023/0644 kishte rekomanduar që kërkesa për listë të kontratave të largohet nga kërkesa e dosjes së tenderit dhe të vendoset lista e furnizimeve të natyrës së ngjashme në harmoni me paragrafin 2.1 të nenit 69 të LPP. Po ashtu eksperti shqyrtues kishte rekomanduar që ky aktivitet i prokurimit të ndahet në Lote për faktin se në këtë aktivitet të prokurimit janë kërkuar dy artikuj të ndryshëm siç është furnizimi me dru dhe furnizimi me pelet. Duke pasur parasysh që operatorët ekonomik mund të jenë të specializuar ose në njërën ose në tjetrën lëmi, ata mund të mos kenë përvojën e duhur, prandaj është më mirë të ndahet në lote ky aktivitet i prokurimit. Në këtë mënyrë autoriteti kontraktues do të merrte furnizim profesional nga kompanitë dhe do të hapte konkurrencën në mes operatorëve ekonomik që kanë përvojën e duhur në lëmin e caktuar. Megjithatë autoriteti kontraktues me rastin e ritenderimit nuk e ka ndryshuar kërkesën fare në përputhje me rekomandimin e ekspertit shqyrtues me ç’rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 69 dhe 69 paragrafin 2 nënparagrafin 1 të LPP. Prandaj Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar dhe kemi të bëjmë me shkelje të nenit 97 paragrafi h) të RRPP pasi që nuk ka vepruar sipas vendimit të OSHP me nr. 2023/644. Si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa 2023/0833 duhet të trajtohet sipas neni 67 të LPP. Po ashtu në përputhje me nenin 105 të LPP, rastet e përsëritura me pretendimet të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar me pare, duhet të trajtohen si çështje të gjykuara dhe sipas nenit 105 të LPP t’i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të korrigjoj shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandaloj dëmtimin e mëtejshëm të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale t’i japin urdhër autoritetit kontraktues që të mënjanojë specifikimet diskriminuese teknike,

ekonomike, financiare ose të përzgjedhjes, kërkesat ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit”.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 65 dhe 67 të LPP si dhe nenin 97 par. h) të RRPP.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit Paneli Shqyrtues në OSHP me datë 03.10.2023 ka marrë edhe vendimin OSHP 2023/0644 përmes të cilit ka përfunduar procedurën administrative për shkak të pajtimit në mes të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Glllogocit dhe Operatorit Ekonomik Ankues “Wood Corporation” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lëndë djegëse - Pelet dhe Dru për nevojat e Institucioneve Komunale - Projekt Korniz” me numër të prokurimit 611-23-8478-1-1-1. Në këtë mënyrë është anuluar në tërësi aktiviteti i prokurimit me nr. 611-23-8478-1-1-1 dhe më pas është ritenderuar me titullin e njëjtë mirëpo sipas nr. të prokurimit 611-23-10866-1-1-1.

Pretendimet ankimore që janë parashtuar përmes ankesës kanë qenë objekt i shqyrtimit edhe sipas ankesës 2023/0644 dhe si të tilla kanë qenë të trajtuara përmes raportit të ekspertit shqyrtues. Tutje përmes raportit të ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0644 lidhur me këto pretendime ankimore ndër të tjera është konstatuar se pretendimet janë të bazuara. Rrjedhimisht është rekomanduar që *“dëshmia nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe Vërtetimi nga Autoriteti Pyjor Komunal të largohen si kërkesa të dosjes së tenderit ndërsa në vend të tyre si kërkesë të jetë vetëm vërtetimi nga gjykata kompetente sipas nenit 65 të LPP”*. Tutje eksperti shqyrtues kishte rekomanduar që *“të largohet nga kërkesa e dosjes së tenderit lista e kontratave dhe të vendoset lista e furnizimeve të natyrës së ngjashme në harmoni me paragrafin 2.1 të nenit 69 të LPP”*. Po ashtu eksperti shqyrtues kishte rekomanduar që *“ky aktivitet i prokurimit të ndahet në Lote për faktin se në këtë aktivitet të prokurimit janë kërkuar dy artikuj të ndryshëm siç është furnizimi me dru dhe furnizimi me pelet”*. Autoriteti Kontraktues ishte pajtuar në tërësi me të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues sipas raportit 2023/0644. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues kishte përfunduar procedurën administrative sipas ankesës dhe kishte marrë vendimin 644/23.

Paneli Shqyrtues ka gjetur se me rastin e ritenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë parasysh (nuk ka zbatuar) asnjë nga të gjeturat e raportit të ekspertit shqyrtues përkatësisht vendimit të Panelit Shqyrtues 2023/0644. Për këto arsye Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë edhe konstatimeve të ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0833 ku thuhet se të gjitha pretendimet ankimore janë të bazuara në tërësi. Paneli shqyrtues vetëm për një pikë do të ndalet në sqarim/konstatim, se pavarësisht se eksperti ka menduar se lista e kontratave duhet të largohet si kërkesë dhe në vend të saj të vendoset listë e furnizimeve, me këtë paneli shqyrtues sqaron se pikërisht paragrafi 2.1 i nenit 69, nëse lexohet në tërësi kërkon që këto furnizime duhet me qenë me kontrata (sepse kërkohet shuma e kontratave), kështu që AK këtë kërkesë nuk ka nevojë ta ndryshoj sepse epilogu është i njëjtë.

Në këtë drejtim Paneli Shqyrtues pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues ku lidhur me pretendimin e parë ankimor thuhet se *“autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me rekomandimet e ekspertizës 2023/644 dhe vendimit të OSHP më të njëjtin numër pasi që ka vendosur kriterin e njëjtë diskriminues dhe në kundërshtim të plotë me rekomandimin që të për zbatimin e nenit 65 të LPP. Po ashtu me aplikimin e kërkesës si më lartë eksperti shqyrtues vlerëson se janë shkel parimet e nenit 7 të LPP. Prandaj Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i dhe kemi të bëjmë me shkelje të nenit 97 paragrafi h) të RRPP”*. Ngjashëm Paneli Shqyrtues pajtohet edhe me konstatimin lidhur me pretendimin e dytë ankimor ku thuhet se *“ankesa 2023/0833 duhet të trajtohet sipas neni 67 dhe 105 të LPP”*.

Me këtë rast Paneli Shqyrtues thekson faktin se vendimet e OSHP duhet të respektohen në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në të kundërtën, mosrespektimi i vendimeve të OSHP përbën shkelje të rëndë ligjore në kuptim të nenit 97 paragrafi h) të RRPP dhe mund të sanksionohet sipas ligjit në fuqi për prokurimin publik si dhe legjislacionit përkatës sekondar. Prandaj Paneli Shqyrtues i tërheq vërejtjen Autoritetit Kontraktues për respektimin pa përjashtim të dispozitave të LPP dhe RRPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të detyruar Autoritetin Kontraktues - Komuna e Gllogocit që të zgjatë afatin për dorëzimin e ofertave si dhe të ndryshoj/plotësoj dosjen e tenderit duke marrë parasysh të gjeturat dhe konstatimet e potencuara më poshtë në këtë vendim si dhe të gjeturat dhe konstatimet e potencuara në vendimin e OSHP 2023/0644 të datës 03.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me lëndë djegëse - pelet dhe dru për nevojat e institucioneve komunale - projekt kornizë ritenderim” me numër të prokurimit 611-23-10866-1-1-1.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së

shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA GLLOGOC**
- **OE - " WOOD COMPANY " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: